



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT
O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN) më datën **24.04.2014** realizoi vizitë pasuese në SP-Dibër e cila kishte për qëllim ta kontrollojë implementimin e rekomandimeve të dhëna në raportin nga vizita e rregullt e realizuar më datën **31.05.2012**. Vizita u realizua me bashkëpunëtor të jashtëm të Shoqatës maqedonase të juristëve të ri e cila është shoqatë e regjistruar për dhënien e ndihmës juridike falas dhe është përfshirë në procedurat për ndihmë juridike të azilkërkuesve në Qendrën pranuese të azilkërkuesve.

AP si MPN realizoi **vizitë të paparalajmëruar pasuese** në SP-Dibër në suaza të mandatit dhe kompetencave të cilat rezultojnë nga Protokolli Fakultativ i Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Johumane, Nënçmuese ose Ndëshkuese dhe Ligji për Avokatin e Popullit.

Në këtë drejtim, MPN konstatoi se pjesa më e madhe e rekomandimeve të adresuara pranë SP-Dibër gjatë vizitës së realizuar në muajin maj të vitit 2012, janë implementuar pjesërishtë.

Nga vizita pasuese u konstatua se akoma nuk ka filluar renovimi dhe ndërtimi i ambienteve të reja për ndalim dhe gjithashtu në këtë stacion nuk ka ambient të veçantë për ndalim të personave të mitur.

Njëherazi MPN konstatoi se nuk ekziston përmirësim sa i përket qasjes së personave me nevoja të posaçme pranë stacionit policor, përkatësisht në hyrje të stacionit akoma nuk ka barrierë të arritshme. Si ambient për ndalim shfrytëzohet ambienti i njëjtë i cili shfrytëzohej edhe gjatë viziës së parë të MPN në këtë stacion policor. Ndryshimet në të njëjtin kishin të bëjnë me heqjen e e kablllove elektrikë. MPN ishte informuar se gjatë kohës së periudhës së dimrit shfrytëzohet ngrohje plotësuese.

Gjatë vizitës pasuese MPN gjithashtu konstatoi se marrja në pyetje e personave të privuar nga liria akoma realizohet në zyrat zyrtare sepse nuk ekziston ambient i veçantë për bisedë me personat derisa të njëjtit privohen nga liria. Gjithashtu në stacionin policor nuk është punësuar udhëheqës i turnit i cili do të ishte përgjegjës për personat e ndaluar, ndërsa në ndërkohë është emëruar inspektor për delikuencën e të miturve.

Nga vizita pasuese u konstatua se ka përmirësim sa i përket udhëheqjes së evidencës për persona të privuar nga liria, por jo në nivel të kënaqshëm, sepse akoma nuk shfrytëzohet forma për dosar individual (përkatësisht dokumentet rruhen në letër të thjeshtë, të bardhë). MPN konstatoi se dosjet individuale përmbajnë procesverbalet dhe dokumentet e nevojshme në përputhje me Procedurat standarde operative, por se procesverbali për ndalim nuk mbushet çdo herë në mënyrë të plotë dhe të drejtë, mirëpo i kushtohet vëmendje mënyrës së plotësimit të pjesës së rrjedhës logjike të ngjarjes (në mënyrë të qartë saktësohet se kur personi është privuar nga liria, ndërkaq, kur është ndaluar në stacionin policor).

Ekipi i MPN-së konstatoi se të drejtat e personave të thirrur, arrestuar ose ndaluar ishin vendosur në shumë gjuhë në pjesën e ambienteve për ndalim, si dhe në ambientin për pranim dhe bisedë me personat e ndaluar. Në përputhje me informatat e pranuar, ky stacion policor nuk disponon me buxhet për ushqim për personat e ndaluar në 10 vitet e fundit.

Si rezultat i vizitës se realizuar pasuese Mekanizmi Parandalues Nacional hartoi raport në të cilin konstatoi gjendjet dhe dha rekomandime përkatëse pranë Ministrisë për Punë të Brendshme dhe pranë vet stacionit policor me qëllim që të eliminohen mangësitë dhe rreziqet.